datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

## V E N D O S I

1. Të vendosë në dispozicion të shtetasit H. A. dokumentet si më poshtë:
  - a) Dosje nr. 26 “Shënime historike mbi Komitetin Shqipëria e Lirë, si pasardhëse e organizatës tradhtare të Ballit Kombëtar”;
  - b) Dosje nr. 27 “Historiku i organizatës tradhtare të Ballit Kombëtar gjatë luftës, Lista emërore e krerëve dhe anëtarëve të saj, skema e organizimit”;
  - c) Dosje nr. 28 “Historiku mbi krijimin e organizatës tradhtare të Ballit Kombëtar dhe veprimtaria e saj armiqësore para dhe pas çlirimit, etj”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

## VENDIME TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË AUTORITETIT

### Vendim nr. 91, datë 04.03.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, V.K.M. nr. 98, datë 15.02.2017 për “Përcaktimin e procedurës së kalimit nën administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në autoritetet e tjera publike”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

### V E N D O S I:

1. Drejtoria e Informacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arkivit, të kryejnë procedurën e trajtimit të kërkesave sipas objektit të tyre, për pajisjen me vërtetim për efekt pensioni për periudhën e internimit/dëbimit ose burgimit të subjektit kërkuar.
2. Miratimin e formatit të vërtetimit me të cilin do të pajisen subjektet aplikuese, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Çdo praktikë e përfunduar, kopja që dorëzohet në arkiv-protokoll, të shoqërohet me kopje të dokumentacionit arkivor të gjendur nga Drejtoria e Arkivit.
4. Sekretariati Teknik në mbledhjet pasardhëse raporton numrin e praktikave të mbyllura.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

### Vendim nr. 174, datë 25.03.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”,

### V E N D O S I

1. Miratimin e draftraportit vjetor të veprimtarisë së punës për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik për përgatitjen e Raportit Vjetor të veprimtarisë së punës për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

**Vendim nr. 181, datë 03.04.2019 ( i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 7 dhe nenin 10 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, nenin 8, germa f) e “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të AIDSSH, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë së punës për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Dërgimin në Kuvend të raportit vjetor të veprimtarisë së punës për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
3. Publikimin në faqen zyrtare të institucionit të raportit vjetor të veprimtarisë së punës për vitin 2018 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
4. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

**Vendim nr. 232, datë 24.04.2019 ( i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 7 dhe nenin 10 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, nenin 8, germa f) e “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të AIDSSH, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën teknike të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
2. Dërgimin e kërkesave buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për fazën strategjike të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

**Vendim nr. 233, datë 24.04.2019 (i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 7 dhe nenin 10 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, nenin 8, germën f) të “Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të AIDSSH, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e rialokimeve të fondeve brenda buxhetit të vitit 2019.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

**Vendim nr. 234, datë 24.04.2019 (i shkurtuar)**

Bazuar në nenin 7 dhe nenin 10 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, nenin 8, germën f) të “Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të AIDSSH, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

**V E N D O S I**

1. Pas nenit 37 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, miratuar me vendimin nr.21, datë 09.05.2017 të AIDSSH, të shtohet neni 38 me emërtesë “Afatet kohore të veprimeve procedurale”, me këtë përmbajtje:
  - a. Pas regjistrimit të kërkesës së paraqitur nga subjekti kërkues në zyrën e arkiv-protokollit, brenda 48 orëve kërkesa siglohet fillimisht nga Kryetarja dhe anëtarët e

- Autoritetit, dhe i kalohet për trajtim Sekretarit të Përgjithshëm, i cili menjëherë ia kalon për ndjekje drejtorisë përkatëse.
- b. Drejtoria përgjegjëse, brenda afatit kohor 3 (tre) ditor, përgatit dhe paraqet në mbledhjen e radhës së Autoritetit relacionin përkatës për miratimin e shqyrtimit të mëtejshëm të kërkesës (legjitimitin e kërkesës).
  - c. Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga institucionet kushtetuese apo autoritetet publike, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar, duke përfshirë dhe vendimmarrjen e Autoritetit, të kryhet brenda afatit kohor prej 30 ditë pune.
  - d. Për shqyrtimin e kërkesave individuale, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar, duke përfshirë dhe vendimmarrjen e Autoritetit, të kryhet brenda afatit kohor prej 6 (gjashtë) muajsh kalendarikë.
  - e. Për shqyrtimin e kërkesave nga studiues/media, procedura për përmbylljen e praktikës së krijuar, duke përfshirë dhe vendimmarrjen e Autoritetit, të kryhet brenda afatit kohor prej 6 (gjashtë) muajsh kalendarikë.
  - f. Personi i interesuar ka të drejtë të ankimojë vendimin e Autoritetit përkatës, sipas nenit 5, pika 6, nenit 39 dhe nenit 40 të ligjit 45/2015, fillimisht në AIDSSH, brenda afatit kohor 30 ditor nga marrja dijeni për vendimin.
  - g. Afati kohor për shqyrtimin e ankimit të personit të interesuar, deri në nxjerrjen e vendimit nga ana e Autoritetit që zgjidh ankimin është 30 ditë.
  - h. Në rast se nga verifikimi i dokumentacionit dhe saktësimi i tij hasen vështirësi, të cilat tejkalojnë afatet kohore të përcaktuara në pikën c), d), e) dhe g) të këtij neni, Autoriteti vendos për shtyrjen e afatit kohor rast pas rasti.
2. Pas nenit 38 me përmbajtjen e sipërcituar, nenet që vijnë në vijim në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, miratuar me vendimin nr.21, datë 09.05.2017 të AIDSSH, të marrin numër rendor rritës.
  3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
  4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare:** Gentiana Sula

**Anëtarë:** Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

## BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR

### **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 4, datë 18.03.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 4, datë 18.03.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Libër i evidencës së punëtorit operativ në zonë, model 4, në ngarkim të G. Z. Libri ka 226 (dyqind e njëzet e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të librit është “sekret”.
2. Libër i evidencës së punëtorit operativ në zonë, model 4, në ngarkim të Xh. Sh., M. B. dhe A. H. Libri ka 525 (pesëqind e njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të librit është “sekret”.
3. Listë funksioni organik i DPB Tiranë për kohë lufte, në ngarkim të M. H. dhe L. M., me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të librit është “sekret”.
4. Regjistër i bashkëpunëtorëve Korçës nr.2/1, GR.II, në ngarkim të A. A. D., numër 7559, me 300 (treqind) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
5. Kartelë model 2 në ngarkim të A. A. D. nr. 7559, pseudonimi “filtra”. Dokumenti daton në vitin 1981.
6. Regjistri i agjunkturës nr.1/1 Tiranë, model K. I, në ngarkim të A. A. D, me nr. 11879, me 179 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
7. Regjistri i dosjeve dhe i fashikujve dhe evidencat e punëtorëve operativë Tiranë, model 9, në ngarkim të M. H., me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
8. Fotokopje e procesverbalit mbi asgjësimin e disa materialeve në ngarkim të M. H., me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
9. Regjistri i dosjeve dhe i fashikujve Sarandë, nr. 36, model 9, në ngarkim të A. Sh. me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.

10. Fotokopje listë veçimi nr. 3 dhe nr. 4, në ngarkim të I. K. me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dokumentit është “sekret”.
11. Fotokopje e fletës së regjistrit të dosjeve dhe të fashikujve, model 9, në ngarkim të I. K. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
12. Fotokopje e fletës së regjistrit të dosjeve dhe të fashikujve, model 9 në ngarkim të K. S. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.
13. Kartelë model 2, në ngarkim të I. T. K., nr. 14.203, i ditëlindjes 1952. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

**Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 5, datë 28.03.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 5, datë 28.03.2019, si më poshtë:

**Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Dosje nr. 11024, F. 2 në ngarkim të B. R. SH., prej së cilës 8 (tetë) janë klasifikuar “sekret”.
2. Fletë e regjistrit nr. 1 Lezhë, model A-4, në ngarkim të P, Gj, P. Regjistri përmban 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

**Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 6, datë 1.04.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në

AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 6, datë 1.04.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Dosje nën/objekti, nr. 174, në ngarkim të Radio Zëri i Amerikës. Dosja ka 254 (dyqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Dosje formulare nr. 1776, kategoria 2/A, si dhe fashikull për të dënuar 5777-A në ngarkim të N. M., me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Dosje e të arratisurit, nr. 372, në ngarkim të R. F. (Sh). Dosja e të arratisurit ka 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. Dosje përpunimi nr. 5294-A, kategoria 2B, në ngarkim të H. S. Dosja ka dy volume, në total me 520 fletë (pesëqind e njëzet) fletë.
5. Dosje përpunimi nr. 1424, kategoria 2A, në ngarkim të A. H. Dosja ka dy volume, në total me 420 fletë (katërqind e njëzet) fletë.
6. Dosje formulare nr. 5945, kategoria 2B, në ngarkim të R. Ç., me 262 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. Dosje formulare nr. 1420, kategoria 2B, në ngarkim të N. D., me 143 (njëqind e dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Dosje përpunimi nr. 6506, kategoria 2A, në ngarkim të K. H. Dosja ka 41 fletë (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”.
9. Dosje formulare nr. 944, kategoria 2A, në ngarkim të S. B., me 195 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. Dosje formulare nr. 128, kategoria 2B, në ngarkim të M. H., me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. Dosje formulare nr. 1971, kategoria 2B, në ngarkim të H. M., me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
12. Dosje agjenturale “Shtriga” (problem i centralizuar) nr. 2776 A, në funksion të kërkesës të shtetases F. Q., me 72 (shtatëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula



## **Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 7, datë 8.04.2019**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 7, datë 8.04.2019, si më poshtë:

### **Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH**

1. Fondi 4, Viti 1961, Dosje nr.140. “Udhëzim dërguar organeve të punëve të brendshme në qendër e periferi mbi detyrat e hetuesisë së Sigurimit të Shtetit”. Dosja ka 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. Fondi 4, Viti 1965, Dosje nr.200. “Udhëzim mbi kriteret e hetuesisë sipas urdhrin nr.01-39, datë 6.7.1965 dhe një udhëzim mbi informacionin që duhet dërguar Degës VIII”. Dosja ka 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Fondi 4, Viti 1971, Dosje 282. “Udhëzim mbi detyrat e hetuesisë para dhe gjatë arrestimit të një personi”. Dosja ka 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
4. Fondi 4, Viti 1986, Dosje 10. “Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme nr.01-6, datë 7.3.1986 “Për ndërtimin dhe organizimin e rrjetit sekret informativ”. Dosja ka 25 (njëzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. Fondi 4, Viti 1983, Dosje 1. “Plan masash për zbatimin e vendimit 73, dt. 8.6.1983, të Byrosë Politike për ndarjen e Hetuesisë nga MPB dhe krijimin si organ më vete korrik-tetor 1983”. Dosja ka 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
6. Fondi 1, Viti 1984, Dosje 12956/1. “Për çështjen penale nr. 456”. Dosja ka 42 (dyzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
7. Fondi 1, Viti 1986, Dosje 12661/17. “Implikime të grupit agjentor dhe sabotues në industrinë e naftës dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme”. Dosja ka 241 (dyqind e dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Fondi 4, Viti 1971, “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e parë. Dosja ka 229 (dyqind e njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. Fondi 4, Viti 1974, “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e dytë. Dosja ka 249 (dyqind e dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

10. Fondi 4, Viti 1974, “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e tretë. Dosja ka 266 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
11. Fondi 4, Viti 1978 “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e katërt. Dosja ka 271 (dyqind e shtatëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
12. Fondi 4, Viti 1979 “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e pestë. Dosja ka 269 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
13. Fondi 4, Viti 1980 “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e gjashtë. Dosja ka 381 (treqind e tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
14. Fondi 4, Viti 1989 “Historiku i Armës së Sigurimit të Shtetit” pjesa e shtatë. Dosja ka 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

## **VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT MARS-PRILL**

**Prezantohet platforma interaktive dhe botimi mbi dosjet e Sigurimit të Shtetit**

**Mbi rolin e shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954)**

**Intelektualët dheurvejimi**

**Tiranë, 7 mars 2019** – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Projekti PERFORM - Shkenca Sociale Aktive dhe të Përgjegjshme bashkëpunuan përgjatë 2018 për ndërtimin e një narrative mbi rolin e shkencës, elitave intelektuale dhe kërkimit shkencor në vitet e para të vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri. Aktiviteti përmbyllës i projektit u zhvillua në mjediset e Akademisë së Shkencave, aty ku zuri fill një vit më parë dhe trajtoi në mënyrë multidisiplinore profilet e akademikëve Gjergj Kokoshi, Eqrem Çabej, Sabiha Kasimati, Arshi Pipa, Aleks Buda, Petraq Pepo, Gjovalin Gjadri, Petraq Qafoku dhe Kolë Kamsi.

Znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit dhe nismëtare e projektit tha mes të tjerash se: “Në punën me arkivin, Autoriteti synon përcaktimin e metadatave dhe përpunimin arkivor që i jep përparësi mbështetjes së axhendës së studimit shkencor, e cila është konsultuar dhe bashkërenduar me organizma akademikë dhe të memories. Kuadri konceptual i punës është ndërtuar në formë matricore dhe ka të bëjë me tematikën, gjeografinë e ngjarjeve dhe kontekstualizimin e tyre”. Mbështetës i projekteve mbi kujtesën, z. Adrian Maître, Ambasador i Zvicrës në Shqipëri, përshëndeti aktivitetin dhe bashkëpunimin, duke e vënë theksin te rëndësia e nxjerrjes në dritë e historive të patreguara dhe puna sistematike për zbulimin e së shkuarës. “Synimi kryesor për fuqizimin e komunitetit të shkencave sociale dhe

mbështetja e iniciativave të ndërmarra nga grupet e studiuesve me aktorët e tjerë në shoqëri, përfshirë sektorin publik, privat, shoqërinë civile dhe median u materializua me platformën online dhe botimin dygjuhësh”, u shpreh z. Martin Dietz, drejtues i projektit PERFORM.

Përgjatë një viti jo me pak sfida, nisma u finalizua me studime të qenësishme, duke rishqyrtuar mbi baza profesionale figura dhe personalitete të shkencës; duke ofruar akses në arkivat e AIDSSH-së dhe shpërndarë këtë informacion në një platformë ndërvepruese komunikimi dhe botuar në dy gjuhë studimet shkencore, për të rinjtë shqiptarë dhe të interesuarit e shumtë jashtë vendit. Hulumtimi i rolit të shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist (1945-1954) bashkoi punën kërkimore arkivore me misionin e Autoritetit për informimin e publikut dhe ruajtjen e kujtesës historike, për hapjen e dialogut publik mbi të shkuarën.

Personalitetet e studiuara, qasja shkencore dhe metodologjia u prezantuan nga historiane Prof. As. Dr. Sonila Boçi, drejtuese e grupit të studiuesve. Me radhë, kërkuesit shkencorë paraqitën punimet e tyre dhe qasjen e përzgjedhur për trajtimin e rolit të ish-Sigurimit të Shtetit si arma më e fuqishme e ruajtjes së pushtetit të Partisë-Shtet mbi shkencën dhe përfaqësuesit më në zë të saj. Prof. As. Dr. Albert P. Nikolla, Dr. Andi Pinari, Prof. As. Dr. Ledia Dushku dhe Prof. Enriketa Pandelejmoni-Papa bashkëpunuan me një grup të rinjsh të përzgjedhur për të finalizuar punimet e tyre. Studentët Doris Pasha, Enxhi Beka, Indrit Qejajaj, Joana Doda dhe Kristi Kolçe ishin pjesë e paraqitjeve dhe ndanë me të pranishmit përvojën e studimit të personaliteteve në fjalë, nëpërmjet dosjeve tëurvejimit.

Platforma ndërvepruese e komunikimit [www.dosjet.gov.al](http://www.dosjet.gov.al) dhe libri “Kur Sigurimi merrej me shkencë” u bënë të njohura për të pranishmit nga Ardita Repishti, Fatmira Nikolli dhe Denis Saatçiu, të cilët, përmes ekspertizës përkatëse prezantuan mundësitë e njohjes me informacionin mbi dosjet e Sigurimit nga të rinjtë, studiuesit apo të interesuarit e tjerë.

Nxjerrja në dritë e informacionit deri dje sekret dhe rikrijimi i kuadrit historik, nëpërmjet kërkimit të mbështetur shkencor, duke dhënë profilet e personaliteteve, duke ndërtuar kohështrirjen e jetës së secilit, duke e gërshetuar atë me tablonë historike, politike, ideologjike e shoqërore të kohës është hapi i parë. Intelktualët akademikë të dhjetëvjeçarit të parë të komunizmit do të pasohen nga profile të intelektualëve të dhjetëvjeçarëve pasues dhe tematika të tjera. Platforma do të pasurohet në vijim me informacion mbi Sigurimin e Shtetit, të vendosur gjithnjë në kontekst historik, duke qenë e aksesueshme për të gjithë, shqiptarë e të huaj dhe e dobishme në disa nivele njohjeje.





## Raportimi i AIDSSH-së në Kuvend për vitin 2018

**Tiranë, 10 prill 2019** - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit raportoi për punën e tij gjatë vitit 2018 në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula bëri një paraqitje të produkteve dhe arritjeve të veprimtarisë së institucionit, duke renditur treguesit kryesorë të fluksit të punës së deritanishme: rreth 1000 kërkesa individuale, ku për rreth 700 prej tyre ka përfunduar procesi; 1300 zyrtarë të verifikuar për dhënien e informacionit mbi ekzistencën e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga kërkesat institucionale; rreth 105 kërkesa nga studiues dhe media, ku janë shërbyer qindra dosje dhe janë digjitalizuar mbi 150 mijë faqe dokumente.

Që nga krijimi e deri më sot, në adresë të Autoritetit janë paraqitur rreth 80 kërkesa me objekt rehabilitimin dhe qartësimin e fatit të vdekurve apo të të zhdukurve, pjesa më e madhe të përfunduara, në proces verifikimi 22 kërkesa.

Gjatë vitit 2019, për shkak të ligjit të vetingut në Policinë e Shtetit dhe për faktin që është vit zgjedhor, pritet dhjetëfishim i punës së Autoritetit.

E fokusuar në tre drejtime: - aksesin i çdo qytetari në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit sipas ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij; vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve/zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, kur kjo kërkohet nga institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, sipas një hierarkie të parashikuar në ligj, si dhe të gjithë të zgjedhurve nga populli, deputetë dhe të zgjedhur vendorë, dhe krijimi i infrastrukturës së duhur për mundësimin e kërkimit shkencor dhe informimin e medias mbi veprimtarinë dhe historikun e ish-Sigurimit të Shtetit, - puna e Autoritetit ka njohur jo pak sfida.

Sipas kryetares Sula, “administrimi i disa qindra mijëra dosjeve, mbi 2.2 km dokumente, ku rreth 70% e tyre përbëjnë sekret shtetëror dhe vënia e tyre në dispozicion të publikut, po ashtu, arritja e sa më shumë qytetarëve, të interesuarve dhe rinisë me informacion mbi të kaluarën, nëpërmjet një strategjie gjithëpërfshirëse komunikimi, që fokusohet te të përndjekurit, familjet e tyre dhe shoqatat e të drejtave të njeriut, të rinjtë dhe publiku i gjerë, e ka zgjeruar ndjeshëm hartën e veprimtarisë së AIDSSH-së në 2018, me komunitetet lokale, si në Shkodër, Tepelenë, Konispol, Pukë, Mirditë, Berat, Korçë e Gjirokastrë. Po ashtu, jashtë vendit, me marrëveshje bashkëpunimi apo shkëmbime përvojash në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermani, Zvicër, Çeki, Poloni, Bullgari, Rumani, Izrael, duke arritur shumë individë, bashkësi dhe institucione të kujtesës”.

Relatori, z. Shametaj, paraqiti komentet për punën e Autoritetit dhe sugjerimet për të ardhmen. Pjesë e diskutimeve, me pyetjet dhe sugjerimet përkatëse ishin deputetët Fino, Hysi dhe Braho, të cilët e vunë theksin tek aktiviteti i Autoritetit për informimin e shoqërisë, që te verifikimi i figurave, deri te rikrijimi i kuadrit historik përmes kërkimit shkencor. Sipas kryetarit të komisionit, z. Ulsi Manja “roli i Autoritetit në zbardhjen e së shkuarës, nëpërmjet dokumentacionit arkivor të administruar, është shumë i rëndësishëm për shoqërinë e sotme shqiptare, që hedh hapa drejt Europës dhe duhet të ndahet qartësisht nga e shkuara komuniste”.

Në emër të Autoritetit, kryetarja Sula paraqiti nevojën për disa ndryshime ligjore, referuar praktikave të krijuara, problematikave të shfaqura gjatë ushtrimit të detyrave funksionale të institucionit, dhe në kuadër të vendosjes së standardeve e unifikimit apo përafrimit të legjislacionit midis Autoritetit dhe institucioneve të tjera kushtetuese apo të pavarura.

Për këtë është parësor bashkëpunimi ndër-institucional, ku AIDSSH është i gatshëm të jetë pjesë edhe e grupeve të punës mbi reformën në sistemin zgjedhor, partitë politike, etj.



Ndryshimet e kërkuara ligjore kanë të bëjnë me ligjin 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”; ligjin 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve dhe praktikave të krijuara, lidhur me procesin e verifikimit të cilësive etike, morale dhe profesionale të punonjësve të MEPJ; ligjin nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me draft/propozim për përmirësime të nevojshme të kuadrit ligjor zgjedhor, për qëllime të transparencës së figurës së kandidatëve gjatë fushatave elektorale, që komisioni i posaçëm i reformës zgjedhore mund t’i materializojë në dispozita të reja ligjore, si dhe ndryshime të mundshme në vendimin nr.188 datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullores për sigurimin e personelit”, si dhe në PyetëSORIN e Sigurisë, në këndvështrimin ligjor të Autoritetit.

Ndryshimet e mësipërme si dhe kërkesat konkrete për mirëfunksionimin e punës së AIDSSH-së iu përcollën Kuvendit të Shqipërisë.



## **Diskutime me grupet e interesit mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 të AIDSSH**

**Tiranë, 24 prill 2019** - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një takim konsultativ me grupet e interesit, në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022. Morën pjesë përfaqësues të shoqatave të të përndjekurve politikë, të të drejtave të njeriut dhe të organizmave që trajtojnë fatet e të zhdukurve me forcë.

Takimi u hap nga kryetarja, znj. Gentiana Sula, e cila nënvizoi rëndësinë e koordinimit me të interesuarit, të përparësive të AIDSSH-së për periudhën në vijim, me dëshirën për të marrë parasysh sugjerimet e të gjithë aktorëve në tryezë dhe harmonizimin e tyre në propozime të përbashkëta.

Në të njëjtën linjë vijuan diskutimin anëtarë i Autoritetit, z. Marenglen Kasmi, dhe sekretari i përgjithshëm, z. Skënder Vrioni, të cilët paraqitën synimet e institucionit dhe qëllimet e tij, si dhe nevojën për mbështetje e koordinim me grupet e interesit.

Znj. Vitoria Fuqi, e sektorit të financës, bëri një paraqitje të plotë të programit buxhetor afatmesëm mbi të cilin po punon Autoriteti për periudhën 2020-2022.

Në përgjigje të objektivave të AIDSSH-së, z. Nebil Çika i Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë u shpreh për vënie të theksit të fati i të zhdukurve me forcë në diktaturë, vendvarrimet e humbura dhe dinamikat njerëzore për zbulimin e së vërtetës dhe dokumentimin e saj. Gjithashtu, te planifikimi i fondeve për thellimin e këtij procesi nga Autoriteti, në bashkëpunim me aktorë të tjerë të përfshirë.

Në emër të ICMP-së, duke vënë në dukje arritjet e deritanishme të institucioneve bashkëvepruese, z. Luigj Ndou shtroi nevojën emergjente për planifikim fondesh të Autoritetit sa i takon çështjes së të zhdukurve, ku - pas ratifikimit të marrëveshjes nga qeveria shqiptare dhe prezantimit të aplikacioneve që gjenden edhe në faqen e Autoritetit, - janë zbuluar 36 vendvarrime të tjera dhe janë regjistruar rreth 600 kërkesa të provuara. Në emër të koordinimit të të gjitha institucioneve e shoqatave që veprojnë në fushën e kujtesës, z. Ardian Kati i Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës e Torturës paraqiti propozimet e veta për mundësinë e bërjes përpara me hapa të përbashkët e të organizuar me të gjithë të pranishmit të tryezë, institucione dhe shoqëri civile. Në këtë linjë ishte edhe fjala e z. Gjonç Gjonçi, përfaqësues i trashëgimtarëve të të pushkatuarve të Shqipërisë.

Diskutimet trajtuan me radhë tema të së shkuarës që duhet vlerësuar me përparësi, në kuadër të përmbushjes së misionit të Autoritetit për transparencë, me nisma ligjore dhe hapa konkretë për akses të të interesuarve në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, për nxitjen e dialogut publik, bashkëpunimin me institucionet dhe qytetarët në çështje të të drejtave të njeriut, duke ndihmuar për hedhjen dritë në të shkuarën dhe përmbushur përgjegjësinë ndaj brezave të rinj për një shoqëri demokratike.





## **Ura bashkëpunimi mes AIDSSH-së dhe bashkësisë shqiptare në Belgjikë**

**Tiranë, 24-27 prill 2019** - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi një vizitë punë në Bruksel, më 24-27 prill, me ftesë të Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Belgjikë dhe Këshillit Kombëtar Shqiptaro-European.

Takimet u organizuan në vazhden e aktiviteteve të nisura tashmë me komunitetet shqiptare jashtë vendit, për informim mbi veprimtarinë e Autoritetit, në përputhje me strategjinë e komunikimit të institucionit.

Në këtë kuadër, kryetari i Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Belgjikë, z. Lek Pervizi mirëpriti ekipin e AIDSSH-së, të cilit i paraqiti skicat dhe vizatimet origjinale që dokumentojnë vendet ku ai dhe familjarë të tij u internuan apo vuajtën dënimin, si kampi i Tepelenës, Kuçi, Plugu e më tej. Z. Pervizi ka përshkuar, përmes imazheve, vizatimeve dhe tablove të realizuara në Shqipëri, në kushte të shtypjes e përndjekjes, rrugëtimin e tij të rezistencës dhe “çlirimin” artistik brenda kufizimit të gjithanshëm, që për rrjedhojë, ishte shpëtimi i tij prej humanisti. Shtëpia e Pervizëve, një galeri në Bruksel, arriti të ekspozonte veç pikturave të Lek Pervizit, edhe tablotë madhështore të të birit, Leonard Pervizi, i lindur dhe rritur në Plug, për t’u arsimuar më pas në Bruksel, ku u afirmua si artist në nivel ndërkombëtar. Shtresëzimet e së shkuarës që kanë të bëjnë me formimin e të dy artistëve janë pjesë domethënëse e krijimtarisë së tyre. Komunikimi me dy artistë dhe personalitete njerëzore të realizuara, të vëna në provë në realitete sfiduese ishte sa interesant, po aq inkurajues për organizime komplekse të përballjes me të shkuarën.

Ekipi i AIDSSH-së zhvilloi një takim në përfaqësinë shqiptare në BE, me ambasadorin e Shqipërisë në Belgjikë, znj. Suela Janina dhe stafin. Bashkëbisedimi trajtoi qëllimet e Autoritetit për ta shtrirë punën e tij informuese edhe në bashkësinë shqiptare në Belgjikë, shumë aktive në realitetin vendas, po ashtu e përfaqësuar në nivele të larta. Diaspora e Belgjikës, apo mërgata, - siç vetëquheshin shqiptarët e arratisur në fund të viteve ‘50 e më tej e të emigruar në Belgjikë nga kampi i Gerovos, Kroaci, - paraqiti interes të madh në njohjen e punës së Autoritetit dhe informimin mbi mënyrën si mund të jenë përndjekur nga Sigurimi i Shtetit. Ky komunitet i larguar në kushte të vështira nga Shqipëria, i vendosur në Belgjikë fillimisht në numër të vogël, u integrua me komunitetin vendas dhe u zgjerua me kalimin e viteve, aq sa mendohet që sot të jenë rreth 60 mijë shqiptarë në territorin belg. Mundësitë e shkëmbimit të informacionit dhe përvojave rezultuan të shumta, ndaj u hodhën hapat e parë për organizime të përbashkëta në vijim, me ndihmën e ambasadës së Shqipërisë.

Pjesë e programit të AIDSSH-së në Bruksel ishte edhe takimi me z. Visho Ajazi, ambasador i Shqipërisë në NATO. E përfaqësuar me të drejta të barabarta, Shqipëria është një ndër shtetet me objektiva të përmbushur në organizatën e Atlantikut të Veriut. Mundësitë e bashkërendimit të hulumtimeve në fushën e kërkimit shkencor, sa i takon ushtrisë dhe marrëdhënieve me të gjatë periudhës ‘44-‘91 rezultuan të frytshme.

Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Belgjikë dhe Këshilli Kombëtar Shqiptaro-European e organizuan simpoziumin me AIDSSH-në në zyrat Space të *European District* në Bruksel, me pjesëmarrjen e dhjetëra përfaqësuesve të komunitetit shqiptar në Belgjikë, të periudhave të ndryshme të arratisjes apo emigrimit. Diaspora e hershme e viteve ‘60 dhe ajo e vonë, shqiptarë me përvoja të ndryshme dhe mbresëlënëse në Shqipëri apo Belgjikë, u bënë bashkë në një takim informues, të dialogut dhe mundësive të thellimit tek e

shkuara, për transparencë, shërim dhe parandalim të shkeljes së të drejtave të njeriut e totalitarizmit në të sotmen e të nesërmen e përbashkët.

Simpoziumin mbi rolin e Sigurimit të Shtetit në diasporë dhe përndjekjen e orkestruar në komunitete specifike e hapën z. Lek Pervizi dhe z. Sulejman Gjana, në emër të Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Belgjikë dhe Këshillit Kombëtar Shqiptaro-European, duke sjellë për të pranishmit edhe përvojat individuale e familjare të mbijetesës, e më pas integritit. Për të prezantuar veprimtarinë e AIDSSH-së, shtyllat sipas të cilave institucioni organizon punën e vet dhe mundësitë për bashkëpunim, e morën fjalën kryetarja e AIDSSH-së, znj. Gentiana Sula, z. Simon Mirakaj, z. Marenglen Kasmi, anëtarë të Autoritetit, dhe z. Skënder Vrioni, sekretar i përgjithshëm.

Sipas znj. Sula, takime të tilla ndihmojnë për “njohjen nga afër me historitë njerëzore të familjeve fisnike dhe kombëtariste që u ndanë për së gjalli nga diktatura, me vuajtjet e tyre gjatë kësaj periudhe të shtypjes dhe izolimit, me kontributin e tyre në kujtesën kolektive, si dhe me sukseset e tyre në sferën profesionale dhe publike”.

Në fund të takimit u shpërndanë formularë aplikimi, të cilët u plotësuan nga të interesuarit dhe u hodhën bazat për vijimin e projektit të dëshmime gojore në Belgjikë, nëpërmjet gazetarëve shqiptarë të angazhuar në mediat prestigjioze vendase. Interesi i madh për të marrë pjesë në një takim që vinte në qendër të shkuarën e përbashkët, kontributi i gjithsecilit me qasjen përkatëse për trajtimin e qenësishëm të periudhës komuniste dhe drejtësisë tranzicionale në Shqipërinë e sotme, duke qenë pjesë e komuniteteve shumë pranë Europës, mbizotëruan dhe krijuan shtratin për bashkëpunim të zgjeruar, të qartë, të mirëpërcaktuar në qëllime e objektiva me Autoritetin dhe kontributin e tij në mbajtjen gjallë të kujtesës kolektive.

Vizita e AIDSSH-së në Bruksel paraqiti punën e Autoritetit të një bashkësi e formuar tashmë, me disa tipologji, dhe themeloi bashkëpunimin e mëpasme me institucionet e shoqatat përfaqësuese shqiptare e europiane, në emër të dialogut shoqëror dhe transparencës për të shkuarën.











AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

---

Adresa  
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë  
[www.autoritetidosjeve.gov.al](http://www.autoritetidosjeve.gov.al)